

prespaNET

A NETWORK OF ENVIRONMENTAL NGOS FOR PRESPA



Ruajtja e natyrës në zemër të Prespës




© I. Shyti

Pavarësisht peripecive të kaluara në vitin 2020, **PrespaNet** ka punuar me përkushtim për të arritur rezultatet më të mira të mundshme në këtë periudhë të vështirë. Që prej kohës së fillimit të projektit, në vitin 2018, numri 3 ka qenë një hajmali për ne; gjatë këtyre 3 viteve, të 3 organizatat tona nga 3 vende të ndryshme kanë bashkëpunuar ngushtësisht, me qëllim dhënien e ndihmës për të ruajtur Prespën tonë të dashur. Megjithatë, 3-shi që na bën më tepër krenarë është ai i 3 zyrave tona lokale në Prespë, një praktikë e iniciuar nga SPP dhe e ndjekur prej MES dhe PPNEA.

Zyrat e reja në zonë i kanë afruar më tepër këto dy organizata me komunitetin lokal dhe natyrën e Prespës, duke i dhënë mundësi për të kuptuar më mirë nevojat e zonës, si të njerëzve, ashtu edhe të natyrës. Prania në zonë ofron një mundësi për të kuptuar lidhjen e ngushtë midis biodiversitetit dhe burimeve natyrore në basen. **Bashkëpunimi ndërkufitar është e vetmja mënyrë për të adresuar çështjet e mëdha, nga të cilat varet gjithçka rreth liqeneve.**

Mbyllja e ciklit të habitateve pranë brigjeve liqenore



- Fshatrat, tokat bujqësore & plantacionet
- Tokë ekologjikisht e vlerësuar

6.822 ha

Zona e studiuar në të tre shtetet, nga e cila **33.98%** cilësohet si habitat prioritar prej BE

Organizatrat partnere këtë vit përmbyllën punën e hartëzimit të habitateve të rëndësishme në brigjet liqenore përgjatë basenit. I njëjti grup ekspertësh që mbështeti punën e MES dhe PPNEA, i kryesuar nga Georgios Fotiadis nga Universiteti Bujqësor i Athinës, përfundoi procesin e hartëzimit ndërkufitar me një ri-freskim mbi habitatet e brigjeve liqenore në anën Greke të Prespës. **Tanimë, për herë të parë, ne disponojmë një pamje të qartë të shtrirjes ndërkufitare të këtyre zonave të rëndësishme.** Ky fakt na nxiti të bashkojmë forcat, së bashku me autoritetet e zonave të mbrojtura në rajon, për të eksploruar mënyrat më të mira për menaxhimin e integruar të habitateve me rëndësi dhe biodiversitetit që ato mbartin.

Bashkoi edhe ti në celebrimin e vlerave unike të habitateve në Prespë, duke fotografuar bimën apo vendin tënd të preferuar. Na trego këto histori duke përdorur hashtag-un **#presaplantplaces!**

Një lum lojërash, njohurish dhe eksperiencash



320

fëmijë të përfshirë në programet tona



Nëse uji është gjaku i jetës në Prespë, që i fal shpirt liqeneve, ligatinave dhe fushave tona, dhe që sjell ngjyrën e gjelbërt në pranverë, atëherë lumenjtë dhe rrjedhat janë venat të cilat shpërndajnë këtë burim të shtrenjtë – që bie në formën e shiut apo të bores – deri poshtë në liqene. Si natyra, ashtu edhe njerëzit, mbështeten në këto rrjedha për të siguruar jetën e tyre. Këto rrjedha janë të rëndësishme edhe për ligatinat, duke i ofruar një burim të vazhdueshëm uji, i cili mundëson mbijetesën e tyre.

Programi i edukimit mjedisor këtë vit u fokusua pikërisht në këto vena magjike, duke shpjeguar se si keqtrajtimi i lumenjve mund të shkaktojë pasoja negative. Nëpërmjet një serë aktiviteteve, **programi në fjalë u përdor për të edukuar fëmijët përgjatë basenit mbi rëndësinë e rrjedhave dhe lumenjve, duke sjellë, edhe njëherë, vlerat natyrore në shkollat e të tre shteteve.** Pandemia solli sfida të shtuara për realizimin e këtij aktiviteti, megjithatë skuadrat tona ja arritën të bëjnë bashkë brezat e rinj nëpërmjet internetit, apo duke konvertuar paketën edukuese në klasë në një libërth të hartuar për të lehtësuar mësimin në shtëpi, që nxënësit mund ta përdornin gjatë karantinës.



Zbulimi i sekreteve të gjitarëve në Prespë



Shumë prej jush mund ta keni parë videon dhe fletëpalosjen e vitit të kaluar mbi jetën e fshehtë të gjitarëve në Prespë. Ne kemi punuar aktivisht për zbulimin e këtyre mistereve, duke eksploruar jetën e gjitarëve nëpërmjet një studimi 3-vjeçar me kamera kurth të drejtuar nga MES. Ky studim konfirmoi praninë e rrëqebullit të **Ballkanit** (*Lynx lynx balcanicus*) në basen, i fotografuar nga stafi i Parkut Kombëtar të Galiçicës!

Në shtetin Grek, SPP hulumtoi dëmet e shkaktuara nga derri i egër, një fenomen që po rritet ndjeshëm në anën e tyre të basenit. Si një përgjigje ndaj

aktivitetit të derrave të egër në livadhet e lagështa të Prespës së Vogël, në bashkëpunim me projektin e LIFE "Shpendët e Ujit në Prespë", disa zona janë rrethuar për të mundësuar kullotjen e bagëtive. Ekipi i PrespaNet është duke përdorur kamerat kurth për të mësuar më tepër rreth impaktit të këtij aksioni në lëvizjet e derrave të egër në zonë.

Bashkëjetesa e mishngrënësve të mëdhenj me praktikën e kullotjes ka qenë fokusi i një studimi paralel të ndërmarrë nga PPNEA dhe MES. Rezultatet kanë treguar se, megjithëse këto konflikte ekzistojnë, ato përballesh me një nivel të lartë tolerance dhe pranimi nga barinjët, me shumë mundësi për shkak se popullata lokale prej shekujsh ka jetuar në afërsi të jetës së egër. Ky studim hodhi dritë edhe mbi çështje të tjera me rëndësi në këto dy vende, siç është mungesa e të rinjve të përfshirë në praktikën e blegtorisë, apo pasiguria e tregut.

Akoma më tej, në një aktivitet pilot në Greqi, ekipi i projektit restauroi një burim ujor afër zonës së kufirit ku një rrugë e re kalimi është duke u planifikuar. Shumë gjitarë kalojnë për te bregu i liqenit nga kjo anë e basenit, për këtë arsye ky burim i ri uji është mëse i domosdoshëm në sigurimin e ujit të pijshëm për këto lloje të rrezikuara, duke mos përjashtuar barinjët dhe tufat e tyre.




Lundërza
Baldosa
Kaprolli
Dhelpër
Ujku
Lepuri i egër
Derri i egër
Rrëqebulli i Ballkanit
Kunadhja
Ariu i murrmë
Dhia e egër
Macja e egër
Zardafi

Gjitarët e kapur nga kamerat tona në këto 3 vite

Së bashku për ligatinat

Shkolla e fundit verore e PrespaNet "Monitorimi i Ligatinave dhe Menaxhimi", si kurrë më parë, u realizua online në verën e vitit 2020. Kjo shkollë verore bashkoi studentë nga të tre vendet rreth basenit dhe u fokusua në punën e projektit të LIFE "Shpendët e Ujit në Prespë", si një rast studimor në menaxhimin e ligatinave. Gjithashtu, duke përdorur stafin ndërkufitar të rrjetit PrespaNet, organizatat partnere ofruan një eksperiencë unike virtuale, duke krijuar një platformë dy javore leksionesh, diskutimesh dhe detyrash.



Kjo shkollë verore paraqiti një miks input-esh nga një numër i konsiderueshëm lektorësh, të cilët mbuluan një varietet të gjerë aspektesh në menaxhimin e ligatinave – nga ndryshimet klimatike të shpendët ujorë, hartëzimi i uejjetacionit të bashkëpunimi ujor ndërkufitar, si dhe nga qeverisja të monitorimi i peshqve. Kjo qasje ndërdisiplinore i nxiti pjesëmarrësit për të menduar mbi kompleksitetin e ligatinave dhe menaxhimit të tyre. Studentët e vlerësuan diversitetin dhe "ndjesinë e bashkëpunimit ndërkufitar", si dhe mundësinë e krijuar për të zhvilluar ide së bashku.

Gjatë 3 viteve të këtij projekti, organizatat partnere sollën një gjeneratë të re shkencëtarësh dhe ruajtësish natyre në Prespë, duke investuar në potencialin për ndërmarrjen e kërkimeve të ardhshme dhe gjenerimin e njohurive që do të ndihmojnë në arritjen e një niveli kuptueshmërie më të lartë mbi ekologjinë shumëfytyrëshe dhe nevojat mjedisore të rajonit.



Të tre skuadrat tona mezi presin vazhdimin e kësaj pune, së bashku me vullnetarët dhe autoritetet e zonave të mbrojtura, duke ndihmuar, sadopak, për ta bërë Prespën një shtëpi më të sigurt, si për natyrën, ashtu edhe për njerëzit!

PrespaNet është një rrjet organizatash jo qeveritare mjedisore për Prespën; SPP, e vendosur në Agios Germanos e cila punon në zonë pothuajse për 30 vjet; MES, një nga organizatat më të vjetra në vend, me zyrë qendrore në Shkup dhe me zyrë lokale në Resen; dhe PPNEA, organizata e pare mjedisore në Shqipëri, që punon me palët e interesit në Prespë që prej mesit të viteve '90, e vendosur në Tiranë dhe me një përfaqësuese lokale në Prespë.

Të tre këto organizata janë duke punuar së bashku mbi projektin 3 vjeçar "Ruajtja dhe mbrojtja e natyrës në basenin ndërkufitar të Prespës nëpërmjet forcimit të rrjetit të organizatave mjedisore", i financuar nga Fondi i Besimit për Natyrën e Ohrit dhe të Prespës dhe Fondacioni Bamirës Aage V. Jensen, me mbështetjen e Fondacionit EuroNatur. Projekti ka si qëllim të rrisë veprimet për ruajtjen e natyrës dhe bashkëpunimin ndërkufitar në basenin e Prespës.